FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.142 25 tetor 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 326 datë 30.9.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes për RACVIAC – Qendra për Bashkëpunim për Sigurinë".....	7691
Ligj nr.10 327 datë 30.9.2010	Për disa shtesa në ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit", të ndryshuar.....	7700
Ligj nr.10 328 datë 30.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar.....	7701
Ligj nr.10 329 datë 30.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar.....	7703
Dekret nr.6699 datë 5.10.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	7705
Dekret nr.6701 datë 6.10.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7705
Dekret nr.6718 datë 11.10.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7706
Vendim i KM nr.734, datë 1.9.2010	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave, për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë.....	7706
Vendim i KM nr.788, datë 29.9.2010	Për shpalljen e zonës arkeologjike "A" të Gradishtës së Selcës, rrethi i Pogradecit, dhe miratimin e rregullores së administrimit.....	7707

Udhëzim i MPPT dhe MF nr.13/1, datë 8.9.2010	Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 "Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar.....	7711
Udhëzim i MF nr.35, datë 7.10.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 "Për akcizat", i ndryshuar.....	7712
Vendim i GJK nr.34, datë 8.10.2010	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.156, datë 3.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr.65, datë 12.2.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, të vendimit nr.293, datë 11.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr.197, datë 3.6.2005 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr.310 datë 14.5.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si të papajtueshme me Kushtetutën	7714

LIGJ
Nr.10 326, datë 30.9.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR RACVIAC – QENDRA PËR BASHKËPUNIM PËR SIGURINË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja për RACVIAC – Qendra për Bashkëpunim për Sigurinë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6720, datë 12.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE MBI RACVIAC – QENDRA PËR BASHKËPUNIM MBI SIGURINË

Hyrje

Shtetet pjesëmarrëse në procesin e bashkëpunimit të Europës Juglindore– (PBEJ/SEECP), palë të Marrëveshjes aktuale (më poshtë referuar si "Palët"),

duke sjellë në kujtesë marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi krijimin e Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA), hartuar në Zagreb më 8 mars 2001,

duke sjellë në kujtesë se në vijim të nenit 1, paragrafi (4) të Marrëveshjes së lartpërmendur, Republika e Italisë e pranoi Marrëveshjen në fjalë më 21 gusht 2002, si dhe Republika e Turqisë më 15 shtator 2004,

duke sjellë në kujtesë vendimet dhe diskutimet e Grupit Këshillimor Ndërkombëtar (më poshtë referuar si "GKN" mbi statusin e ardhshëm ligjor dhe strategjinë e re të Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA),

të vetëdijshme për përpjekjet e investuara në krijimin e një bashkëpunimi më të ngushtë rajonal dhe të vendosur për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal,

të gatshme për të bashkëpunuar ngushtë me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR), si dhe me të gjitha iniciativat dhe marrëveshjet e tjera rajonale,

ndërkohë që është përgjegjësia dhe detyra e të gjitha vendeve në Europën Juglindore të nxisin dialogun dhe bashkëpunimin mbi çështjet e sigurisë në Europën Juglindore nëpërmjet një partneriteti ndërmjet njëri-tjetrit, si dhe me partnerët e tyre ndërkombëtarë,

të bindur mbi nevojën për të riorganizuar Qendrën e Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA) për të kontribuar drejt hapjes së aktiviteteve të QMRKVIA ndaj të gjitha palëve të gatshme për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje,

të vetëdijshme se është në interesin e tyre të përbashkët të marrin pjesë në aktivitetet e qendrës së riorganizuar dhe modernizuar të Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA) dhe për të përfituar nga progresi dhe arritjet e deritanishme të saj,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
KRIJIMI, MISIONI DHE VEPRIMTARITË

Neni 1
Krijimi

1. Palët në këtë mënyrë krijojnë QMRKVIA– Qendrën për Bashkëpunim mbi Sigurinë (më poshtë referuar si "QMRKVIA").

2. QMRKVIA është pasardhësi i ligjshëm i Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve të krijuar nëpërmjet "Marrëveshjes së Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi krijimin e Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA)", hartuar në Zagreb, më 8 mars 2001, pranuar nga Republika e Italisë më 21 gusht 2002 dhe Republika e Turqisë më 15 shtator 2004.

3. QMRKVIA– Qendra për Bashkëpunim mbi Sigurinë është një organizatë ndërkombëtare, e pavarur, jo fitimprurëse, rajonale dhe akademike.

Neni 2
Misioni

Misioni i QMRKVIA është të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mbi çështjet e sigurisë në Europën Juglindore nëpërmjet një partneriteti ndërmjet palëve dhe partnerëve të tyre ndërkombëtarë.

Neni 3
Shtrirja e veprimtarive

QMRKVIA realizon misionin e saj duke promovuar kryesisht:

a) Dialogun mbi sigurinë dhe reformën mbi sektorin e sigurisë, kontrollit të armëve, si dhe mbi besimin dhe ndërmarrjen e masave për organizimin e sigurisë;

b) Sinegjinë me organizata dhe institucione të tjera, si NATO, BE, OSBE, si dhe me partnerë bilateralë për të gjitha çështjet me interes dhe shqetësim të përbashkët;

c) Bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR) dhe me të gjitha iniciativat dhe marrëveshjet e tjera rajonale;

d) Një dialog me shoqërinë civile, akademikët dhe opinionistët.

KAPITULLI II
ANËTARËT E QMRKVIA

Neni 4
Anëtarët

1. Palët në këtë Marrëveshje janë anëtarë të QMRKVIA.

2. Anëtarët mbështesin sekretariatin me personel dhe japin kontribut financiar për buxhetin e QMRKVIA sipas rregullave financiare.

3. Pozicioni i kryetarit të Grupit Këshillimor Ndërkombëtar (GKN) dhe pozicioni i drejtorit

mbeten posaçërisht të hapur për t'u plotësuar nga anëtarët. Pozicionet e tjera të larta të hapura posaçërisht për plotësim nga anëtarët përcaktohen nëpërmjet një vendimi të veçantë nga ana e GKN.

Neni 5
Anëtarët e asociuar

1. Statusi i anëtarit të asociuar mbetet i hapur në bazë të një kërkese me shkrim për çdo shtet i cili shpreh gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar dhe kontribuar për QMRKVIA.

2. GKN vendos për sa i përket aplikimit.

3. Statusi i anëtarit të asociuar kërkon plotësimin e personelit dhe/ose kontribut financiar dhe/ose kontribut në natyrë për operacionet e QMRKVIA.

4. Statusi i anëtarit të asociuar mund të pezullohet ose t'i jepet fund me vendim të GKN-së, sipas dispozitave të marrëveshjes aktuale.

5. Anëtarët e asociuar mund të ndjekin mbledhjet e GKN-së, dhe të marrin pjesë në punën e tij sipas nevojës.

Neni 6
Vëzhguesit

1. Shtetet e tjera të interesuar si dhe organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe institucionet mund të marrin pjesë në QMRKVIA si, vëzhgues pas aprovimit nga ana e GKN.

2. GKN vendos për sa i përket aplikimit për vëzhgues pranë QMRKVIA.

3. Statusi i vëzhguesit mund të pezullohet ose t'i jepet fund me vendim të GKN, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

4. Vëzhguesit pranë QMRKVIA mund të ndjekin mbledhjet apo të marrin pjesë në punën e GKN, por pa të drejtë vote.

KAPITULLI III
ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E QMRKVIA

Neni 7

Grupi Këshillimor Ndërkombëtar (GKN)

1. GKN është organi i vetëm vendimmarrës i QMRKVIA.

2. GKN vepron si komitet drejtues për QMRKVIA. GKN jep orientime për të garantuar operimin dhe zhvillimin e QMRKVIA.

Neni 8
Përbërja e GKN

1. GKN përbëhet nga një përfaqësues nga secili anëtar.

2. GKN emëron kryetarin e tij për një periudhë njëvjeçare, e cila mund të zgjatet prej GKN për një vit shtesë. Me përjashtim të një periudhe të mundshme kur mbivendoset, kryetari i GKN dhe drejtori i QMRKVIA nuk do të jenë përfaqësues nga i njëjti shtet.

3. Drejtori i QMRKVIA do të jetë një këshilltar i përhershëm i GKN, merr pjesë në takimet e GKN dhe gëzon të drejtën për të bërë propozime pranë GKN.

Neni 9
Procedurat

1. GKN mblidhet rregullisht dy herë në vit.

2. Takimet e mëtejshme mund të mbahen sa herë që kryetari e gjykon të arsyeshme ose me kërkesën e të paktës 1/3 së anëtarëve të GKN.

3. GKN mund të marrë vendime kur më shumë se gjysma e anëtarëve të tij janë të pranishëm. Vendimet e GKN merren me konsensusin e anëtarëve të pranishëm. Konsensusi kuptohet si mungesë kundërshtimi.

4. Në rast se një vendim i GKN kërkohet të merret ndërmjet takimeve, i cili nuk mund të shtyhet për në takimin e radhës të GKN, aplikohet një procedurë e heshtur. Procedura e parashikuar në nënparagrafin 3 të këtij neni aplikohet gjithashtu për marrjen e një vendimi me anë të procedurës së heshtur.

5. Një anëtar mund të mos përfaqësohet nga një anëtar tjetër gjatë takimeve të GKN.

6. Stafi i QMRKVIA mund të ndjekë takimet e GKN me kërkesë të GKN ose drejtorit.

7. Përfaqësues të shteteve, organizatave ndërkombëtare ose rajonale, organeve ose individëve mund të ftohen nga ana e kryetarit të GKN-së, pas një konsultimi me anëtarët, si të ftuar të veçantë për t'iu drejtuar takimit të GKN-së ose për të informuar GKN mbi fusha të veçanta me interes.

Neni 10
Detyrat e GKN

GKN vendos:

1. mbi udhëzimet e përgjithshme për operimin e QMRKVIA;

2. mbi vlerësimin e masave të ndërmarra, propozimeve të bëra dhe raporteve të paraqitura nga ana e drejtorit dhe rishikon progresin e QMRKVIA;

3. mbi emërimin e kryetarit të GKN dhe drejtorit të QMRKVIA;

4. mbi miratimin e termave të referencës (TR) të GKN, si dhe mendimit të TR dhe të gjitha rregulloreve të tjera të nevojshme për punën e tij dhe punën e QMRKVIA;

5. mbi implementimin e buxhetit të vitit aktual;

6. mbi buxhetin e vitit fiskal pasardhës;

7. mbi raportin vjetor të auditimit;

8. mbi planin vjetor, përfshirë veprimtaritë e propozuara për t'u realizuar, financimin e tyre dhe burimet që nevojiten;

9. mbi politikën e fuqisë punëtore për stafin e QMRKVIA;

10. mbi ndryshimet në strukturën e përgjithshme të organizatës dhe tabelën e fuqisë punëtore;

11. mbi negocimin dhe nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit ose dokumenteve politike me palët e treta dhe autorizon ose kryetarin e GKN ose drejtorin e QMRKVIA për nënshkrimin e këtyre dokumenteve;

12. mbi datën dhe vendin e takimeve të GKN dhe aprovon protokollin e këtyre takimeve;

13. mbi të gjitha çështjet e tjera që gjykohen të përshtatshme.

Neni 11
Sekretariati

1. QMRKVIA do të ketë një sekretariat, si organ ekzekutiv i saj, të kryesuar nga drejtori. Sekretariati asiston GKN dhe organet e tij vartëse në realizimin e funksioneve të tyre. Ai kryen detyrat e parashikuara në këtë Marrëveshje. Ai kryen funksionet e tjera të caktuara sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe funksionet e deleguara nga ana e GKN.

2. Sekretariati ndër të tjera:

a) përgatit dhe i paraqet GKN draftin e planit vjetor dhe të buxhetit të organizatës;

b) përgatit dhe i paraqet GKN draftin e raportit të organizatës mbi implementimin e kësaj Marrëveshjeje dhe raporte të tjera sipas kërkesës së GKN;

c) i siguron GKN dhe organeve vartëse të tij mbështetje administrative dhe teknike;

d) adreson dhe merr njoftime në emër të organizatës për dhe nga anëtarët, anëtarët e asociuar dhe vëzhguesit mbi çështje që i përkasin implementimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Sekretariati informon GKN mbi çdo problem që ka dalë në lidhje me kryerjen e funksioneve të tij, që kanë të bëjnë me implementimin e kësaj Marrëveshjeje, për të cilin është njoftuar dhe nuk ka mundur ta zgjidhë apo qartësojë nëpërmjet konsultimit me anëtarët, anëtarët e asociuar dhe vëzhguesit e interesuar.

4. Sekretariati është përgjegjës për të garantuar realizimin e detyrave të tilla që mund të kërkohen për të siguruar funksionimin e duhur të QMRKVIA.

Neni 12
Drejtori

1. Drejtori emërohet nga GKN me rekomandim të anëtarëve për një periudhë trevjeçare, të rinovueshme me vetëm një mandat tjetër, por jo pas saj.

2. Drejtori mban përgjegjësi para GKN për emërimin e stafit dhe organizimin e funksionimin e sekretariatit. Vetëm shtetasit e anëtarëve emërohen si drejtorë.

3. Drejtori përfaqëson kryetarin e sekretariatit dhe vepron si këshilltar i përhershëm pranë GKN, në përputhje me nenin 8 paragrafi 3.

4. Drejtori është përgjegjës për të garantuar funksionimin normal dhe efikas të QMRKVIA. Drejtori i raporton dhe është përgjegjës para GKN.

Neni 13
Personeli dhe rekrutimi

1. Organizimi i QMRKVIA strukturohet dhe aprovohet nga GKN për të siguruar një përgjigje sa më efikase, të efektshme dhe fleksibile ndaj nevojave të shteteve të GKN. Organizimi i QMRKVIA siguron një strukturë e cila drejtohet në nivel rajonal dhe administrative e logjistike në mënyrë të pavarur.

2 Personeli i QMRKVIA përfshin drejtorin, zëvendësdrejtorin, stafin plotësues dhe stafin tjetër administrativo-teknik të sekretariatit.

3. QMRKVIA plotësohet kryesisht me personelin e vënë në dispozicion të cilët janë të hapur ndaj koordinimit dhe bashkëpunimit, të aftë në gjetjen e zgjidhjeve multilaterale dhe me edukim, përvojë dhe kualifikime të mjaftueshme për të përmbushur funksionet e pozicionit të punës. Në rastin kur pozicionet rezervohen posaçërisht për vendin pritës, Republika e Kroacisë si vendi pritës siguron vënien në dispozicion të personelit mbështetës.

4. Vëzhguesit, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe institucionet mund të vënë në dispozicion dhe/ose caktojnë staf për projekte të veçanta në mënyrë të përkohshme në pritje të një vendimi nga GKN.

5. Rregulloret përfshijnë rregulla, parime dhe procedura që rregullojnë përzgjedhjen e personelit, rekrutimin e tyre, klasifikimin e pozicioneve dhe operimin efikas të sekretariatit të QMRKVIA në realizimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14
Kushtet e punësimit

1. GKN, me vendim, përcakton rregulloret e personelit të QMRKVIA. Këto, të paktën, reflektojnë parimet e mëposhtme:

a) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, shtetasit e të gjithë anëtareve dhe anëtarëve të asociuar gëzojnë mundësi të barabarta për punësim pranë QMRKVIA. Rekrutimi udhëhiqet nga nevoja për realizimin e duhur të përgjegjësive të sekretariatit.

b) Përzgjedhja dhe promovimi dhe të gjitha aspektet e tjera të administrimit të personelit realizohen sipas parimit të meritës dhe duke respektuar kërkesat e paanshmërisë, transparencës, diversitetit dhe përfaqësimit nga të gjithë anëtarët.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me personelin realizohet me anë të një paneli gjykatësish të krijuar sipas një vendimi të veçantë të GKN.

Neni 15
Paanshmëria

1. Në realizimin e detyrave të tyre, drejtori dhe personeli i sekretariatit nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga asnjë anëtar i veçantë i GKN ose nga ndonjë shtet apo autoritet jashtë GKN.

2. Secili anëtar, anëtar i asociuar ose vëzhgues respekton karakterin e veçantë ndërkombëtar të përgjegjësive të drejtorit dhe personelit tjetër dhe nuk kërkon të ndikojë në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

KAPITULLI IV
ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 16
Financimi

1. QMRKVIA financohet nëpërmjet kontributeve të rregullta vjetore të anëtarëve, si dhe kontributeve vullnetare, donacioneve dhe burimeve të tjera.

2. Shkalla e shpërndarjes së kontributeve dhe afatet kohore të transferimit të kontributeve të anëtarëve përcaktohet në rregulloret financiare.

Neni 17
Buxheti vjetor

1. Buxheti i QMRKVIA përcaktohet në bazë vjetore dhe përmbajtja e tij përcaktohet në rregulloret financiare.

2. Buxheti vjetor përcakton të ardhurat dhe shpenzimet totale të vitit. Buxheti vjetor balancon gjithmonë të ardhurat totale vjetore që mbulojnë shpenzimet totale vjetore. QMRKVIA nuk lejohet të hyjë në borxhe, përveç kur vendoset nga GKN.

3. Autoriteti final për buxhetin vjetor i takon GKN, bazuar në propozimin e paraqitur nga ana e drejtorit të QMRKVIA, paraprakisht, por jo më vonë se 90 ditë para fillimit të vitit fiskal të QMRKVIA.

Neni 18
Raportimi financiar

1. Drejtori i paraqet GKN raporte vjetore mbi zbatimin e buxhetit vjetor. Raporti i nënshtrohet aprovimit nga ana e GKN.

2. Realizohet një auditim vjetor nga auditorë të pavarur mbi përdorimin e buxhetit vjetor. Raporti i auditimit i nënshtrohet aprovimit nga ana e GKN. Raporti i auditimit bëhet më vonë publik.

3. GKN vendos mbi auditorët e jashtëm të pavarur, si dhe mbi auditimin e jashtëzakonshëm i cili mund të propozohet nga çdo anëtar GKN.

KAPITULLI V
ZOTËSIA LIGJORE, PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Neni 19

1. QMRKVIA e ka selinë në Republikën e Kroacisë.

2. Një marrëveshje e vendit pritës do të lidhet ndërmjet QMRKVIA dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

3. Gjuha zyrtare e punës do të jetë gjuha angleze.

Neni 20
Zotësia ligjore

1. QMRKVIA gëzon zotësi të tillë ligjore për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, sipas nevojës, me qëllim ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e objektivave të saj.

2. Ajo ka autoritetin të kontraktojë dhe marrë pjesë në seanca gjyqësore, duke përfshirë përfitimin dhe shitjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

Neni 21
Privilegjet dhe imunitetet e QMRKVIA

QMRKVIA, ambientet dhe pasuria e saj, gëzojnë në Republikën e Kroacisë, si vend pritës, një status të barabartë me statusin e akorduar misioneve diplomatike sipas Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961.

Neni 22
Privilegjet dhe imunitetet e personelit

1. Drejtori, zëvendësdrejtori, si dhe bashkëshortët/et e tyre dhe anëtarë të familjeve të tyre gëzojnë në territorin e Republikës së Kroacisë, si vend pritës, një status të barabartë me statusin e akorduar agjentëve diplomatikë dhe bashkëshortëve/eve të tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre sipas konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961.

2. Të gjithë anëtarët e tjerë të personelit të QMRKVIA dhe bashkëshortët/et e tyre dhe anëtarët e familjeve të tyre gëzojnë në territorin e Republikës së Kroacisë, si vend pritës, një status të barabartë me statusin e akorduar stafit administrativ dhe teknik dhe bashkëshortëve/eve të tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre sipas konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961. Në veçanti, ata gëzojnë të drejtën e importimit të pajisjeve për të plotësuar nevojat shtëpiake, si dhe të drejtën për të importuar ose blerë një mjet motorik për përdorim vetjak të përjashtuara nga detyrimet doganore dhe tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) brenda një viti nga data e marrjes së detyrës në Republikën e Kroacisë, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar.

3. Nëse një anëtar i personelit të QMRKVIA është shtetas ose rezident i përhershëm i Republikës së Kroacisë, si vend pritës, sidoqoftë ai/ajo, në territorin e Republikës së Kroacisë, gëzon imunitet për sa u përket veprimeve të kryera në cilësinë e tij/saj të një zyrtari. Kjo e drejtë imuniteti nuk aplikohet për personelin e rekrutuar sipas paragrafit 4 të këtij neni.

4. QMRKVIA mund të rekrutojë personel ndihmës në nivel lokal sipas nevojës sipas legjislacionit kombëtar të Republikës së Kroacisë.

KAPITULLI VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Amendime

1. Kjo Marrëveshje mund të amendohet me propozim të secilës palë.

2.Çdo propozim i tillë mund t'u komunikohet të gjitha palëve të tjera nga ana e depozituesit për vlerësim dhe aprovim.

3. Palët njoftojnë depozituesin sa më shpejt që të jetë e mundur mbi pranimin e amendimeve të propozuara për këtë Marrëveshje.

4. Amendimet e aprovuara me konsensus sipas paragrafit 3 hyjnë në fuqi sipas nenit 27.

Neni 24
Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Neni 25
Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26
Tërheqja

1. Një palë e kësaj Marrëveshje mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim për t'u tërhequr, drejtuar depozituesit. Një njoftim i tillë mund të hyjë në fuqi jo më herët se fundi i vitit financiar të QMRKVIA, në të cilin njoftimi u depozitua pranë depozituesit.

2. Një palë e kësaj Marrëveshjeje nuk lirohet nga detyrimet për shkak të tërheqjes së saj nga detyrimet financiare të shkaktuara gjatë kohës kur ajo ishte palë e kësaj Marrëveshjeje.

3. Një palë e kësaj Marrëveshjeje e cila është tërhequr nga Marrëveshja aktuale mund për pasojë të aplikojë për aderim në Marrëveshje sipas nenit 28 ose për vëzhgues pranë QMRKVIA sipas nenit 6.

Neni 27
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga ana e shteteve nënshkruese sipas kërkesave ligjore përkatëse të tyre.

2. Kjo Marrëveshje hapet për t'u nënshkruar më datë [GKN vendos mbi këtë datë] dhe mbetet e hapur për nënshkrim për dy muaj pasardhës.

3. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit mbas datës në të cilën i pesti i shteteve, që kanë nënshkruar këtë Marrëveshje, të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit apo miratimit pranë depozituesit.

4. Për shtetin nënshkrues që ratifikon, pranon apo miraton këtë Marrëveshje mbas datës së hyrjes së saj në fuqi, sipas paragrafit 3 të këtij neni, kjo Marrëveshje hyn në fuqi për shtetin në fjalë ditën e parë të muajit të parë mbas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit pranë depozituesit.

Neni 28
Aderimi

1. Mbas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo shtet jo nënshkrues pjesëmarrës i SEECP mund të aderojë në këtë Marrëveshje.

2. Ofrimi i kësaj Marrëveshjeje për aderim nga ana e shteteve jashtë shteteve pjesëmarrëse të SEECP i nënshtrohet një vendimi të veçantë të GKN.

3. Për shtetet që aderojnë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, marrëveshja hyn në fuqi ditën e parë mbas datës së depozitimit të instrumentit të saj të aderimit pranë depozituesit.

Neni 29
Dispozita tranzitore

1. Të gjitha vendimet e mëparshme të Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve, në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, gjykohen si vendime të QMRKVIA–Qendra për Bashkëpunim mbi Sigurinë, me kusht që të mos kundërshtojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të gjitha pasuritë që i përkasin Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA) i transferohen QMRKVIA.

3. Të gjitha shtetet që janë anëtare të asociuara të Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA) gëzojnë statusin e përcaktuar në këtë Marrëveshje, përveçse kur njoftojnë ndryshe.

4. Të gjitha vendet, organizatat ose institucionet ndërkombëtare që janë vëzhguese pranë Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontrollin, Verifikimin dhe Implementimin e Armëve (QMRKVIA) gëzojnë statusin e përcaktuar në këtë Marrëveshjeje, përveçse kur njoftojnë ndryshe.

Neni 30
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të një mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve ose ndërmjet një pale dhe QMRKVIA, lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, palët e interesuara kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të përbashkëta. Kur mosmarrëveshje të tilla nuk zgjidhen brenda një periudhe gjashtëmujore, palët e interesuara e paraqesin mosmarrëveshjen pranë GKN për vlerësim dhe marrjen e masave të duhura.

Neni 31
Depozituesi

Qeveria e Republikës së Kroacisë është depozituesi i Marrëveshjes aktuale.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në [vendi], më [data] në një kopje të vetme origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.10 327, datë 30.9.2010

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9290, DATË 7.10.2004 "PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 23 pika 1 shkronja "a", pas nënpikës "vii" shtohen nënpikat "viii" dhe "ix" me këtë përmbajtje:

"viii) vendos pezullimin e veprimtarisë deri në shlyerjen e detyrimit nga subjekti fizik dhe juridik;

ix) vendos sekuestrimin e mjeteve dhe të makinerive, të cilat punojnë gjatë kohës që subjekti është i pezulluar.".

Neni 2

Në nenin 25, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Këshilli i Ministrave miraton formularët përkatës, që dokumentojnë procedurat e zbatuara nga INUK-ja, sipas përcaktimeve të bëra në nënpikat "viii" dhe "ix" të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6721, datë 12.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 328, datë 30.9.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002 "PËR DOKUMENTIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:
"Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë".

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
1. Në pikën 1, fjalia e dytë shfuqizohet.
2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:
"3. Shtetasi aplikon për letërnjoftim elektronik në zyrat e aplikimit.
4. Letërnjoftimi tërhiqet nga vetë shtetasi në zyrat e aplikimit.
5. Procedura e aplikimit dhe dokumentet që paraqiten për aplikim përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.".

Neni 3

Në nenin 3, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:
"a) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.".

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Letërnjoftimi elektronik lëshohet me afat 10 vjet nga data e lëshimit.".

Neni 5

Në nenin 5, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:
"ç) është dëmtuar.".

Neni 6

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1

Letërnjoftimi shpallet i pavlefshëm kur:
a) ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i tij e ka siguruar në mënyrë të paligjshme;
b) vërtetohen rastet e përcaktuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nenit 5.".

Neni 7

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6

Letërnjoftimi është një dokument identiteti, në të cilin janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda informatike:
a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit:
i) numri personal (nup);
ii) emri;
iii) mbiemri;
iv) shtetësia;
v) vendlindja;
vi) datëlindja;
vii) gjinia;
b) fotografia e mbajtësit të këtij dokumenti;
c) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;
ç) elemente sigurie, brenda normave të Komunitetit Europian, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.".

Neni 8
Dispozitë kalimtare

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me letërnjoftim elektronik janë të përcaktuara në kontratën koncesionare, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008. Me përfundimin e kësaj kontrate, këto tarifa do të jenë objekt i përcaktimit nga ky ligj.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6722, datë 12.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 329, datë 30.9.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006 "PËR MASAT NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6, pas shkronjës "g" shtohet shkronja "gj" me këtë përmbajtje:
"gj) ngritjen e një qendre kombëtare të shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.".

Neni 2

Në nenin 8, pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:
"7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktima jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktima.
8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Në nenin 9 pika 1, fjalët "postës së policisë" zëvendësohen me fjalët "stacionit të policisë".

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:
1. Në pikën 1 shkronja "g", fjala "konfiskojnë" zëvendësohet me fjalën "sekuestrojnë".
2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:
"4. Në rastin e zbatimit të shkronjës "g", vendimi i gjykatës parashikon:
a) pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrit të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje;
b) kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.".

Neni 5

Në nenin 13 pika 2, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:
“dh) policia/prokuroria;
e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.”.

Neni 6

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:
1. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike u njoftojnë gjykatave listën e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike falas.”.
2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:
“4. Kërkuesi shkarkohet nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifat për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbarimore shtetërore, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi. Me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.”.

Neni 7

Në nenin 18, pika 1 ndryshohet si më poshtë:
“1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:
a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;
b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.”.

Neni 8

Në nenin 19 pika 5, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) zyrave përmbarimore të vendit të ekzekutimit.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6723, datë 12.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

DEKRET
Nr.6699, datë 5.10.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Anri Hylber Qato
2. Ardian Isuf Troka
3. Ardit Hasan Kurtaj
4. Aron Ardian Troka
5. Elona Kristo Bojaxhiu (Strakosha)
6. Elton Llazar Bojaxhiu
7. Klarita Hetem Topalis (Capunaj)
8. Luana Petrit Haus-Korbi (Korbi)
9. Vilson Ylli Balla

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6701, datë 6.10.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Ahmet Mahmut Çalik
2. Çiğdem Nuri Çalik
3. Mahmut Can Ahmet Çalik
4. Emel Halit Aksoy
5. Aysel Mahmut Aksoy

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6718, datë 11.10.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Salvatore Antonio Bellavita
2. Enina Reshad Dallku (Deva)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.734, datë 1.9.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE, PËR KRIJIMIN E REZERVAVE STRATEGJIKE TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8 të nenit 26 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e rezervës strategjike, me rëndësi kombëtare, të lëndës drusore në këmbë, për t'u përdorur vetëm në raste emergjente, për plotësimin e nevojave të ekonomisë për lëndë drusore dhe furnizimin e popullatës me dru zjarri e lëndë ndërtimi.

2. Rezervat strategjike, me rëndësi kombëtare, administrohen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore.

3. Ngastrat dhe nënngastrat pyjore, në pronësi publike, që do të shërbejnë si rezervë strategjike të lëndës drusore në këmbë, të përbëjnë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes e 15 për qind të vëllimit të lëndës drusore të pyjeve shtetërore, si dhe jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes e vëllimit të lëndës drusore të pyjeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, dhe të caktohen sipas kritereve të mëposhtme:

a) të jenë në përputhje me plotësimin e nevojave për të përballuar rastet emergjente;

b) të jenë sa më afër qendrave të banuara, të kenë një shpërndarje homogjene, sipas ndarjes administrative të territorit të Republikës;

c) të jenë të përshkueshme me rrjet rrugor, që mundëson përdorimin e tyre në çdo kohë, dhe të mos jenë zona me rrezikshmëri të lartë për t'u prekur nga zjarri.

Shfrytëzimi i lëndës drusore nga rezervat strategjike bëhet për rastet e emergjencave të mëdha, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

4. Procedurat që duhet të ndiqen për krijimin e rezervave strategjike janë:

a) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjeve vendore përcaktojnë ngastrat dhe nënngastrat që do të shërbejnë si rezerva strategjike të lëndës drusore në këmbë;

b) Ngastrat dhe nënngastrat që do të shërbejnë si rezervë strategjike të lëndës drusore në këmbë, miratohen nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bazë të studimit dhe të planeve të mbarështimit, që do të kryhen për këtë qëllim nga strukturat në varësi të saj, brenda një viti nga dalja e këtij vendimi, dhe rishikohen çdo 10 (dhjetë) vjet;

c) Rezervat strategjike të miratuara duhet të menaxhohen sipas objektivave të përcaktuara në këto plane;

ç) Në pyjet e përcaktuara si rezerva strategjike ndalohet të kryhen ndërhyrje silvikulturore, me përjashtim të prerjeve sanitare, ndalohet kullotja, ndezja e zjarreve, dhënia në përdorim, heqja nga fondi pyjor, si dhe ushtrimi i veprimtarive të tjera të çfarëdolloji.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.788, datë 29.9.2010

PËR SHPALLJEN E ZONËS ARKEOLOGJIKE "A" TË GRADISHTËS SË SELCËS, RRETHI I POGRADECIT, DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës arkeologjike "A" të Gradishtës së Selcës, rrethi i Pogradecit, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores së administrimit të zonës arkeologjike "A" të Gradishtës së Selcës, rrethi i Pogradecit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

PIKAT E MARRA ME GPS “GARMIN 60” TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” TË GRADISHTËS SË SELCËS SË POSHTME, POGRADEC

ZONA ARKEOLOGJIKE “A”
POZICIONIMI GJEOGRAFIK

Nr. i pikës	Koordinatat
1	N40 59.653 E20 31.116
2	N40 59.611 E20 31.058
3	N40 59.601 E20 31.010
4	N40 59.570 E20 30.998
5	N40 59.545 E20 31.000
6	N40 59.521 E20 31.001
7	N40 59.496 E20 31.001
8	N40 59.477 E20 31.016
9	N40 59.460 E20 31.042
10	N40 59.441 E20 31.045
11	N40 59.385 E20 31.017
12	N40 59.356 E20 31.031
13	N40 59.364 E20 31.061
14	N40 59.350 E20 31.091
15	N40 59.350 E20 31.133
16	N40 59.338 E20 31.170
17	N40 59.359 E20 31.218
18	N40 59.342 E20 31.241
19	N40 59.318 E20 31.249
20	N40 59.299 E20 31.249
21	N40 59.289 E20 31.261
22	N40 59.313 E20 31.306
23	N40 59.340 E20 31.310
24	N40 59.351 E20 31.297
25	N40 59.389 E20 31.310
26	N40 59.511 E20 31.306
27	N40 59.578 E20 31.241
28	N40 59.650 E20 31.129
29	N40 59.391 E20 31.357
30	N40 59.368 E20 31.343
31	N40 59.349 E20 31.363
32	N40 59.347 E20 31.405
33	N40 59.361 E20 31.419
34	N40 59.388 E20 31.413
35	N40 59.393 E20 31.406

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE "A" TË GRADISHTËS SË SELCËS, RRETHI POGRADEC

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonës arkeologjike "A" të Gradishtës së Selcës, rrethi Pogradec, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar.

Neni 2
Ndërhyrjet në zonën arkeologjike "A" të Gradishtës së Selcës, rrethi Pogradec

Në zonën arkeologjike "A" të Gradishtës së Selcës, rrethi Pogradec lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

2. Rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 3m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara. Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe që në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi. Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 3
Gjetjet arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet arkeologjike, struktura murale (varre monumentale, pjesë mozaiku të shtrirë në një sipërfaqe mbi 4 m^2, afreske, ndërtime inxhinierike, pjesë arkitekturore që lidhen me strukturat murale dhe banesa, tempuj e godina të tjera shërbimesh).

2. Në rast gjetjesh të rëndësishme të paluajtshme, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore shpalljen monument kulture të një objekti të paluajtshëm, Instituti i Monumenteve të Kulturës bën studimin e zonës mbrojtëse të saj brenda 30 ditëve nga zbardhja e vendimit për shpalljen monument kulture.

Neni 4
Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike, zhvillohet gërmimi i shpëtimit. Gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit, ose nga subjekte private me leje të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

2. Në rast se gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit gjykohet e nevojshme asistenca shkencore dhe teknike në terren e specialistëve të Institutit të Arkeologjisë, kërkohet zyrtarisht pjesëmarrja e tyre në gërmim.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësisë së veçantë (strukturë etj.), Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe propozon në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Në përfundim të çdo gërmimi shpëtimi përgatitet një relacion i plotë, i cili i paraqitet Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

5. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, relacioni firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij, si dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

6. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga një subjekt privat, relacioni firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit, minimumi 2 arkeologë të këtij subjekti dhe nga specialisti i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, i cili ka qenë prezent gjatë gërmimit.

Neni 5

1. Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor (*survey*) dhe sondazhet arkeologjike kryhen nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit. Në çdo projekt të ndërmarrë nga subjektet, është e detyrueshme pjesëmarrja e një përfaqësuesi të autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

2. Kur subjekti privat kryen shkelje duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe relaton menjëherë në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, duke propozuar edhe masat përkatëse. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik vulos kantierin dhe e monitoron atë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit.

3. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, pasi shqyrton rastin, vendos:

- Lënien në fuqi të vendimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për pezullimin e punimeve;

- Shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe lejimin e vijimit të punimeve.

4. Në rastet kur subjekti privat nuk e kryen gërmimin sipas kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë i delegon Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik të vazhdojë gërmimet.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë është i formës së prerë.

Neni 6

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike "A" vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, bëhet vetëm në vendet e përcaktuara sipas rastit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike dhe zbatohet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit.

2. Në asnjë rast tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentin.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre bëhet në mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit.

4. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonën arkeologjike "A", vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Pogradecit.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitarë (jokulturorë) dhe politikë, si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme).

Neni 7

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, bazuar në të dhënat e reja arkeologjike, si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 8

Në hartimin e instrumenteve të planifikimit të territorit për Gradishtën e Selcës, rrethi Pogradec duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i Gradishtës së Selcës, rrethi Pogradec dhe përcaktimet e kësaj rregullore.

Instrumentet e planifikimit të territorit për Gradishtën e Selcës, rrethi Pogradec që janë në fazën e zbatimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre duhet të rishikohen me qëllim që të zbatohet zonifikimi arkeologjik i Gradishtës së Selcës, rrethi Pogradec dhe përcaktimet e rregullores përkatëse.

UDHËZIM
Nr.13/1, datë 8.9.2010

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN NR.6257, DATË 2.9.2008 "MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane", të ndryshuar, dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë",

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 "Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 5, germa (a), në fund të fjalisë shtohet paragrafi:

"ose banojnë nën normat e strehimit, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.814, datë 3.12.2004"

2. Pas pikës 7/5 shtohet pika 7/6 me këtë përmbajtje:

"7/6. Familja qiramarrëse në ish-pronë private detyrohet të lirojë banesën e pronarit brenda 30 ditëve nga data e lëvrimit të kredisë".

3. Pas pikës 21, shtohet pika 22 me këtë përmbajtje:

"22.Transferimi nga subjektet përfituese sipas këtij udhëzimi, i kredive të marra për strehim në banka të tjera përpara fillimit të këtij programi, mund të bëhet kur është praktikisht e realizueshme në marrëveshje midis bankës ku është marrë kredia dhe bankës që zbaton programin, vetëm në rastet kur familja plotëson kushtet sipas pikës 5 të këtij udhëzimi dhe kriteret e përcaktuara në pikat 5 e 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë".

Shuma e kredisë për të cilën mund të subvencionohen nuk mund të jetë më e madhe se ajo e përcaktuar në këtë udhëzim dhe në shkresat e institucioneve përkatëse për subjektet që përfitojnë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007.

4. Në të gjithë tekstin e udhëzimit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit zëvendësohet me Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.35, datë 7.10.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 "PËR AKCIZAT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 "Për akcizat", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2.12. zëvendësohet me pikën 2.12, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"2.12. Importuesit e "maltos", "granulatës" (të kreut 3901 deri 3904 të NKM) dhe "pipetës" (të kreut 3923 të NKM), që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize, subjekte të prodhimit të birrës dhe produkteve plastike, duhet të bëjnë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë autorizim për importimin e maltos, granulatës, pipetës, për qëllime tregtie. Autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jepet për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë përsëritjeje. Çdo subjekt që do të bëjë kërkesë për autorizim si importues i maltos, granulatës, pipetës, për qëllime tregtie, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë më shumë se 3 vjet i regjistruar në organet tatimore si person i tatueshëm i TVSH-së.

b) Të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vet ekonomike.

c) Të mos ketë detyrime tatimore dhe doganore të pashlyera.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo autorizim të lëshuar për tatimpaguesit si importues të maltos, pipetës dhe granulatës. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zhdoganimi i pipetës dhe granulatës bëhet me kilogramë.

Importuesi i autorizuar, për çdo rast të importimit të maltos, pipetës dhe granulatës, duhet të depozitojë si garanci përpara zhdoganimit, në një llogari bankare, 120 lekë për kg malto të importuar dhe 100 lekë për kilogramë granulatë, pipetë, garanci (zhdoganimi për granulatën dhe pipetën do të bëhet në kilogramë), e cila do t'i kthehet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të shitjes së maltos, granulatës dhe pipetës, te tatimpaguesit e autorizuar si prodhues birre apo te tatimpaguesit prodhues të produkteve plastike.

Në rastet kur një tregtari të autorizuar për importimin e maltos, granulatës ose pipetës, i gjenden sasi të maltos, granulatës ose pipetës të padokumentuara ose vërtetohen shitje tek persona të paautorizuar si prodhues birre dhe/ose prodhues produktesh plastike, për këto sasi ai detyrohet të paguajë 120 lekë për kg malto tatim dhe 100 lekë për kg granulatë, pipeta tatim dhe i hiqet e drejta e

ushtrimit të këtij aktiviteti duke i tërhequr autorizimin si importues malto, gralulate ose pipete, për një periudhë 2-vjeçare. Organi tatimor ka të drejtë të mbajë garancinë e depozituar për kompensimin e dëmit ekonomik. Nëse personi nuk ka garanci ose ajo nuk është e mjaftueshme për përballimin e dëmit ekonomik, tatimpaguesi paguan shumën totale ose pjesën që nuk mbulohet nga garancia, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit nga organi tatimor. Në të kundërt organi tatimor zbaton procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.".

2. Pika 29 zëvendësohet me pikën 29 me përmbajtje si më poshtë vijon:

"29. Proceset e miratuara nën regjimin e rimbursimit të akcizës

29.1 Proceset e miratuara të përcaktuara në nenin 19(2)(a) janë:

a) prodhimi i produkteve të pranuara mjekësore të miratuara nga organi tatimor dhe që u nënshtrohen procedurave të pikës 30 më poshtë;

b) prodhimi i uthullës që u nënshtrohet procedurave në pikën 31 më poshtë;

c) prodhimi për tregtim i mallrave ushqimore duke përdorur pije alkoolike;

ç) prodhimi i alkoolit të denatyruar që u nënshtrohet procedurave të pikës 32 dhe 33 më poshtë;

d) Prodhimi i mallrave jo të tatueshme me akcizë nga lëndë të para për të cilat është paguar akcizë.

29.2 Akciza e paguar mbi mallrat të cilat janë përdorur në proceset e miratuara më lart jashtë magazinës tatimore mund të bëhet objekt i një kërkese për rimbursim.

29.3 Sipas dispozitave të kësaj pjese, kur një person i vërteton organit tatimor që:

- çdo sasi alkooli e tatueshme, për të cilën është paguar akcizë, është përdorur në një proces të miratuar në pikën 29.1 më lart, ai person ka të drejtë të bëjë kërkesë në organin tatimor për rimbursimin e akcizës së paguar mbi mallrat përkatëse të akcizës të përdorura në prodhimin e atij produkti.

29.4 Rimbursimi i akcizës, në lidhje me ndonjë sasi alkooli, nuk duhet bërë përveçse ndaj një personi, i cili:

- është personi që ka përdorur alkoolin apo pijen alkoolike në një proces të miratuar të specifikuar në paragrafin 29.1 më lart dhe kryen një biznes si furnizues produktesh të renditura në paragrafin 29.1 më lart, të cilat nxirren apo prodhohen për qëllimet e atij biznesi.

29.5 Çdo person që blen mallra akcize që do të përdoren në një proces të miratuar, duhet të sigurohet që fatura të përfshijë:

a) një numër serial vijues;

b) sasinë dhe llojin e mallrave të blera të akcizës;

c) detyrimin e akcizës mbi ngarkesën.

29.6 Rimbursimi do të bëhet vetëm kur mund të verifikohet evidenca e përdorimit të mallrave të akcizës në procesin e miratuar dhe të jetë paguar akciza që kërkohet nga rimbursimi. Çdo person që dorëzon një kërkesë për rimbursim të tatimit të akcizës së paguar mbi mallrat që janë përdorur në një proces të miratuar, duhet të mbajë të dhënat e mëposhtme (përveç të dhënave të zakonshme tregtare) dhe t'i dorëzojë ato sa herë që kërkohen nga organi tatimor:

a) regjistrimet e alkoolit të marrë dhe të përdorur;

b) faturat që tregojnë shumën e akcizës së paguar për mallrat.

29.7 Pas marrjes së kërkesës për rimbursim, së bashku me dokumentet mbështetëse, Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse, nëse bindet, do të marrë masa për miratimin e rimbursimit, që do të paguhet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përveçse në rastet kur kërkesa i nënshtrohet një investigimi të mëtejshëm për të verifikuar vërtetësinë e saj.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.34, datë 8.10.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Petrit Plloçi	anëtar	i " "
Vitore Tusha	anëtare	e " "
Sokol Sadushi	anëtar	i " "
Sokol Berberi	anëtar	i " "
Admir Thanza	anëtar	i " "
Altina Xhoxhaj	anëtare	e " "
Xhezair Zaganjori	anëtar	i " "

me sekretare Blerina Çinari, në datë 21.9.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: Lutfi Domi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.156, datë 3.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i vendimit nr.65, datë 12.2.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, i vendimit nr.293, datë 11.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i vendimit nr.197, datë 3.6.2005 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe i vendimit nr.310, datë 14.5.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.310, datë 14.5.2004, ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të "shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese", duke e dënuar atë me 7 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.197, datë 3.6.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.293, datë 11.5.2005, vendosi "lënien në fuqi të vendimit nr.197, datë 3.6.2005 të Gjykatës së Apelit Durrës përsa i përket deklarimit fajtor, cilësimit ligjor të veprës e masës së dënimit për të gjykuarin Dritan Domi (bashkautor me kërkuesin). Prishjen e vendimit të mësipërm për të gjykuarin Lutfi Domi (kërkuesin) e dërgimin e akteve për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Durrës me një tjetër trup gjykues."

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.65, datë 12.2.2007, ka vendosur "lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për të pandehurin Lutfi Domi sa i takon deklarimit fajtor, kualifikimit të veprës penale në ngarkim të tij dhe ndryshimin vetëm për masën e dënimit."

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.156, datë 3.4.2009, ka vendosur:

"Mospranimin e rekursit të paraqitur si nga prokurori ashtu edhe nga kërkuesi".

Kërkuesi, më datë 9.5.2008, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese për këto arsye:

a) Kërkuesit i është cenuar e drejta e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme për shkak se në të njëjtin proces gjyqësor, në shkallë të ndryshme, kanë marrë pjesë 2 gjyqtarë të njëjtë. Kështu, në procesin për caktimin e masës së sigurimit për kërkuesin, gjyqtarja Majlinda Andrea ka vendosur masën e sigurimit të arrestit me burg. Po kjo gjyqtare ka qenë në trupin gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkuesit që ka vendosur

mospranimin e tij. Gjithashtu, gjyqtari Besnik Imeraj ka qenë anëtar i trupit gjykues për shqyrtimin e apelimit ndaj vendimit të sigurimit të provës së dëshmitares. Po ky gjyqtar ka marrë pjesë në shqyrtimin e rekursit të kërkuesit që ka vendosur mospranimin e tij.

b) Kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes, pasi në seancën për sigurimin e provës kërkuesit i është caktuar avokat kryesisht, megjithëse ai nuk ishte shprehur se kërkonte avokat.

c) Mbrojtja e kërkuesit nuk ka qenë efektive, pasi të dy të pandehurit janë mbrojtur nga i njëjti avokat gjatë seancës për sigurimin e provës.

Në datë 21.7.2010, kërkuesi paraqiti një kërkesë tjetër para kësaj Gjykate, me anë të së cilës kërkoi heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se "Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes." Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Procedurës Civile (KPC), neni 299/b, i cili parashikon se "gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë" .

Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", dhe nenin 299 të KPC-së, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar) Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 22.10.2010
Doli nga shtypi më 25.10.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 30 lekë